



RAPORTI I - IX - | PËR MUJIN TETOR 2010

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Raporti i Monitorimit mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë Kundër Korrupsionit

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID-i përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e USAID ose ISC.



PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	5
Hyrje.....	6
Qeveria e Kosovës.....	7
Kuvendi i Kosovës.....	8
Raportimet e Gazetave.....	10
Raportet nga Shoqëria Civile.....	10
Lëvizja FOL.....	11
KDI.....	11
IPOL.....	11
Falënderime.....	11
Rreth Lëvizjes “FOL”.....	11

LISTA E AKRONIMEVE

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK – Agjencia Kundër Korrupsionit

BQK – Banka Qendrore e Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

DHKEK – Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

ISC – Institute for Sustainable Communitities (Instituti për Komunitete të Qëndrueshme)

KDI – Kosovo Democratic Institute (Instituti Demokratik i Kosovës)

LDD – Lidhja Demokratike e Dardanisë

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

PK – Policia e Kosovës

SSP – Sektori i Standardeve Profesionale

TI – Transparency International

PËRMBLEDHJE

Nga 8 vendime të Qeverisë së Kosovës për muajin tetor asnjë një vendim nuk ka qenë në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky muaj shënjon muajin më të dobët të aktiviteteve qeveritare në luftë kundër korrupsionit;

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur 3 seanca plenare. Gjatë këtyre seancave janë parashtruar gjithsej 25 pyetje parlamentare, 10 prej të cilave kanë qenë për korrupsion. Deputetët më aktivë kanë qenë Driton Tali me 4 pyetje parlamentare, Naim Rrustemi me 3 dhe Riza Smaka me 3;

Nga 66 artikuj të publikuar nga gazetat e përditshme (Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe Express), vetëm 20 janë realizuar si tema, 41 lajme dhe 7 intervista. Derisa Koha Ditore dhe Zëri janë fokusuar më shumë në kritikën ndaj Ekzekutivit të vendit dhe ndërmarrjeve publike, kritikën e Kosova Sot janë përqendruar më shumë në Gjyqësorin e Kosovës. Ndërkaq, gazeta Express në dështimet e ministrive të LDK-së dhe të Komunës së Prishtinës;

Gjatë muajit tetor organizatat jo-qeveritare kanë publikuar Raportin e Progresit Shqip, i cili është një version kosovar për Kosovën. Ky raport ofron një pasqyrë alternative ndaj progresit në Kosovë, duke reflektuar pikëpamjen dhe vlerësimin e organizatave të shoqërisë civile kosovare mbi fushat esenciale të qeverisjes shtetërore

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë ka arrestuar dy persona për krim të organizuar dhe kontrabandë.

HYRJJE

Korrupsioni, i vlerësuar si sfida kryesore për shoqërinë e Kosovës përgjatë 11 viteve të transicionit, vazhdon të mbetet shqetësim i përbashkët i të gjithëve: politikanëve, shoqërisë civile e mediave. Ndërkombëtarët adresojnë këtë çështje në raportet/vlerësimet e tyre të përvitshme dhe qëndrimet deklarative. Bashkimi Evropian me Raportet e Progresit, e Departamenti Amerikan i Shtetit me raportet periodike për çështje të veçanta, mbesin vërejtjet publike që Kosova i merr pothuajse rregullisht viteve të fundit. Ndërsa raportet e organizatave jo qeveritare ndërkombëtare për Kosovën, kanë qenë të vazhdueshme dhe shpesh herë më të ashpra në adresimin e korrupsionit.

Vendasit mbeten të ndarë në qasjen për korrupsionin dhe luftën kundër tij. Përderisa pushtetarët zotohen për ‘zero tolerancë korrupsionit dhe krimit të organizuar’, opozita adreson të kundërtën, duke e cilësuar ‘qeverinë – koka e korrupsionit’. Qëndrimet e tyre për çështjen në fjalë ndryshojnë me ndërrimin e pushtetit, e bashkë me të edhe rolet e tyre. Përgjatë qeverisjes nën administrimin e UNMIK-ut, dhe pas shpalljes së pavarësisë, publiku kosovar në rolin e spektatorit ka mundur të përcjell rokadën e pushtetit dhe retorikën pothuajse boshe për luftën kundër korrupsionit. Çështja e statusit, e më pas bërja e shtetit, janë shndërruar Atutë kryesore pas të cilave politikanët kosovarë janë fshehur vazhdimisht.

Dy vite pas shpalljes së pavarësisë, raportimet investiguese të medieve për korrupsionin, instalimi i Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit, EULEX, dhe forcimi i thirrjeve të shoqërisë civile, kanë prioritetizuar ‘luftën kundër korrupsionit’. Edhe pse


arrestimi i ‘peshqve të mëdhenj’ është zëvendësuar me të vegjlit, madje në nivel komunal, pritjet që ndërkombëtarët dhe Kryeministri Thaçi kanë krijuar për qytetarët, do ta shoqëroj edhe për një kohë politikën ditore në Kosovë.

Lëvizja FOL vazhdon monitorimin e aktiviteteve të institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit. Në periodikun e nëntë me radhë, për muajin tetor, shihet qartazi mungesa e aktiviteteve institucionale në luftë kundër korrupsionit. Qeveria, Kuvendi, Gjyqësori dhe institucionet janë duke bërë shumë në reduktimin e mundësisë së abuzimit me autoritetin dhe paranë publike.

QEVERIA E KOSOVËS

Qeveria e Kosovës, e krijuar nga një koalicion i madh ndërmjet PDK-së dhe LDK-së në vitin 2008, është goditur në muajin tetor nga tërheqja e njëanshme e LDK-së nga koalicioni qeverisës. Kjo tërheqje ka rezultuar pas akt-gjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila kishte konstatuar shkelje të rëndë kushtetuese nga ana e ish-presidentit Sejdiu.¹ Vendimi për tërheqje është marrë nga kryesia e kësaj partie, por, sipas saj, kjo parti do të “mbetet e përkushtuar të jetë kontribuese e fuqishme në të gjitha proceset demokratike” e shtetërore në interes të Kosovës.² Në këtë kontekst, zhvillimet e tilla kanë ndikuar që të mos ndërmerret asnjë aktivitet në luftë kundër korrupsionit. Për dallim nga muajt tjerë, ku janë marrë shumë vendime, në këtë muaj janë miratuar vetëm 8 vendime. Nga këto vendime sa ka marrë gjithsej, asnjë prej tyre nuk ka qenë në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në kuadër të tyre është edhe një vendim që rregullon ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 50.000.00 euro në muaj për periudhë njëvjeçare për Kompaninë Ndërkombëtare PATTON, BOGGS, LLP, me seli në Ëashington D.C. me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së interesave të Republikës së Kosovës jashtë vendit. Bazuar në këtë vendim, pra, qindra mijëra euro do të paguhen në

Ilogari të kësaj kompanie si rezultat i gabimeve të Qeverisë së Kosovës në procedurat e prokurimit. Në këtë kontekst, qeveria duhet të jetë e kujdesshme në proceset e tenderimit dhe prokurimit, sepse kjo po i shkakton humbje të mëdha Kosovës dhe po ndikon në ngritjen e nivelit të korrupsionit në instancat më të larta dhe më të ulëta publike. E korrupsioni rrezikon qeverisjen e mirë, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik³ dhe dëmton proceset demokratike.⁴



Tab (1): Vendimet e Qeverisë – Muaji Tetor 2010

Ndërkaq, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, EULEX, ka arrestuar 2 persona në Mitrovicën Veriore, të cilët akuzohen për armëmbajtje, shantazh dhe pengim të ushtrimit të

¹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës: Rasti Nr. KO 80/10, 7 Tetor 2010

² Me gjerësisht shih <http://balkanweb.com>, 16 Tetor 2010

³ Rreth efekteve negative të Korrupsionit shih <http://ëëë.oecd.org>

⁴ James B. JACOBS: Korrupsioni dhe Demokracia, Kappa Phi Journal, Volumi 84, 2004, fq. 21

detyrës zyrtare.⁵ Po ashtu, ka ngritur padi kundrejt zyrtarëve të Medicus, e cila akuzohet për trafikim të organeve njerëzore, krim të organizuar, ushtrim të paligjshëm të veprimtarive mjekësore dhe për abuzim të detyrës zyrtare.⁶Gjatë këtij muaji është emëruar edhe shefi i ri i EULEX-it, Xavier Bout de Marnhac. Në vizitën e tij tek Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Jakup Krasniqi, Marnhac ka pohuar se prioriteti i tij do të jetë “vendosja e sundimit të ligjit në Mitrovicën Veriore dhe luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar”.⁷

KUVENDI I KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës gjatë muajit tetor ka mbajtur gjithsej 3 seanca plenare. Gjatë këtyre seancave nuk është vërejtur përkushtim i madh nga ana e deputetëve për të ngritur/denoncuar afere të ndryshme korruptive. Në kohën e pyetjeve parlamentare janë bërë vetëm 10 pyetje për korrupsion dhe 15 pyetje për çështje tjera. Në bazë të nenit 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit⁸, koha për pyetje parlamentare është e kufizuar në 50 minuta. Kjo kohë është pothuajse e “ngjashme” me interpelancat parlamentare, ku deputetët mund t’i shprehin brengat dhe hallet e qytetarëve të Kosovës. Mirëpo, mungesa e pranisë së ministrave është duke pamundësuar funksionimin e nenit 26 të Rregullores së Re të Kuvendit⁹ – që krijon hapësirë solide për

⁵ EULEX: <http://ëëë.eulex-kosovo.eu>, Press Release, 4, 6 Tetor, 2010


⁶ Po aty, Padi në Rastin e Klinikës Medicus, 15 Tetor, 2010

⁷ Po aty, Emërohet Shefi i Ri i Misionit, 15 Tetor, 2010

⁸ Neni 26.1 i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, miratuar me 20 Maj 2005, e ndryshuar dhe e plotësuar me 1 Qershor 2006.

⁹ Neni 26 i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, miratuar me 20 Maj 2005, e ndryshuar dhe e plotësuar me 1 Qershor 2006.

deputetët e interesuar që të parashtrorjnë pyetje parlamentare në adresë të kabinetit qeveritar. Kjo ka bërë që shumë deputetë të heqin shpeshherë dorë nga parashtrimi i pyetjeve dhe t’i përsërisin për të saten herë ato. Sipas statistikave të treguara më poshtë rezultojnë që deputetët nuk kanë adresuar edhe aq shumë çështjet që i mendojnë qytetarët e vendit.



Tab (2): Numri i pyetjeve parlamentare - Tetor

Në kuadër të kësaj kohe për pyetje parlamentare, më të zëshmit dhe më të interesuarit për të denoncuar afere të ndryshme korruptive janë deputetët: Driton Tali me 4 pyetje, Naim Rustemi me 3 pyetje dhe Riza Smaka me 3 pyetje njëjshu. Këta deputetë, jo vetëm në këtë muaj, por edhe në muajt paraprakë kanë qenë më të angazhuar në hulumtimin dhe ngritjen në nivel të debatit çështje që dyshohet për afere të mundshme korruptive. Nga kjo shihet që deputetët e pavarur janë më të lirë në

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

shprehjen e shqetësimeve të qytetarëve të Kosovës, ndërkaq deputetët me mandat imperativ janë më të kufizuar në parashtrimin e pyetjeve parlamentare për korrupsion.




Tab (2): Statistikat e deputetëve që kanë bërë pyetje për afere të ndryshme korruptive - Tetor

lajme, në mesin e tyre ekzistojnë gazeta që realizojnë edhe tema të ndryshme, të cilat më pastaj janë ngritur në nivel të debatit. Nga 66 artikuj të publikuar nga gazetatat e përditshme (Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe Expressi), 41 janë realizuar si tema dhe 26 lajme. Koha Ditore dhe Zëri më shumë kanë qenë të fokusuar në Qeverinë dhe Ndërmarrjeve Publike të Kosovës. Ndërkaq, kritikata e gazetës Kosova Sot ka qenë më shumë të fokusuar në Gjyqësorin e vendit dhe më pak për Qeverinë dhe Ndërmarrjet Publike, ndërkaq Express-i më shumë në nivel lokal. Konstatim të ngjashëm kishte nxjerrë edhe Raporti i Reporterëve pa kufij, sipas të cilit Koha Ditore dhe Zëri më shumë kanë ruajtur pavarësinë e tyre gazetareske.¹⁰

RAPORTIMET E GAZETAVE

Të gjitha gazetatat e monitoruara nga stafi i Lëvizjes FOL, të cilat vizatojnë dhe pasqyrojnë zhvillimet e gjithmbarshme në Kosovë, shpërfaqin një nivel të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndonëse shumica e raportimeve të mediave janë të përqendruara në

ab (5): Statistikat e Raportimeve Anti-Korrupsion të



Gazetave - Muaji Gusht 2010

RAPORTET NGA SHOQËRIA CIVILE

Edhe shoqëria civile në Kosovë, e cila pranohet gjerësisht se është esenciale për proceset demokratizuese në vendin tonë, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në luftë kundër korrupsionit dhe praktikave tjera korruptive. Qëllimi i aktiviteteve të shoqërisë civile, përkatësisht e organizatave jo-qeveritare, ka qenë denoncimi i praktikave korruptive dhe deformuese të keq-qeverisjes. Në këtë kontekst, gjatë muajit tetor organizatat jo-qeveritare kanë publikuar Raportin e Progresit Shqip, i cili është një version kosovar në pritje të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, raport ky që ofron një pasqyrë alternative ndaj progresit në Kosovë, duke reflektuar pikëpamjen dhe vlerësimin e organizatave të shoqërisë civile kosovare mbi fushat esenciale të qeverisjes shtetërore.¹¹

LËVIZJA FOL - Gjatë këtij muaji ka publikuar Raportin e saj Tremujor mbi Aktivitetet Institucionale në Luftë Kundër Korrupsionit. Ky Raport është prezantuar në një Tryezë të Rrumbullakët “Korrupsioni: Ndërmjet Luftës dhe Retorikës”, në të cilën ka marrë pjesë edhe Koordinatorja Anti-Korrupsion, Drita Hajdari. Gjatë këtij debati janë identifikuar problemet aktuale që e shoqërojnë luftën kundër korrupsionit dhe mundësitë për intensifikimin e saj, në mënyrë që të reduktohen mundësitë e abuzimit me autoritetin dhe paranë publike. Gjatë këtij muaji FOL ka reaguar edhe ndaj nivelit të lartë të korrupsionit që ishte konstatuar nga Raporti i Transparency International. Sipas këtij Raporti Kosova është renditur në vendin e 110 – krahas shteteve më të korruptuara dhe më të dështuara në botë.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS - KDI ka publikuar raportin mujor të monitorimit të punës ë

Kuvendit të Kosovës, ku ka gjetur të meta dhe parregullsi të cilat po pengojnë mbarëvajtjen e punës së këtij institucioni dhe në të cilin ka akuzuar kryeministrin Thaci për ndërhyrje politike në Kuvend.

INSTITUTI BALLKANIK I POLITIKAVE – IPOL ka organizuar një tryezë të rrumbullakët në Ferizaj me temën “Lufta kundër Korrupsionit”.¹² Në këtë tryezë janë nxjerrë shqetësimet dhe rekomandimet nga pjesëmarrësit që lufta e tillë të intensifikohet dhe të fuqizohet edhe më shumë, në mënyrë që të ndodhë reduktimi i aferave korruptive.

¹¹ Me gjerësisht shih <http://levizjafol.org>, 25 Tetor, 2010

¹² IPOL: <http://policyinstitute.eu>, 13 Tetor, 2010

FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga ISC – Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë ëebfaqe: ëëë.monikorr.org

RRETH LËVIZJES “FOL”

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

KONTAKTO:

Andrea Gropa 29, 100000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

Mob: +377 (0) 44 131 542

Ueb: levizjafol.org

E-mail: info@levizjafol.org